

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe Standardizimi i Produkteve Vendore

HULUMTIM & ANALIZË E POLITIKAVE

09/2018



Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe Standardizimi i Produkteve Vendore

Autor: **Dardan Abazi**
Burim Ejupi

Programi: **Qeverisje Demokratike**

Publikimi: **Qershor 2018**

Foto e ballinës: **Unsplash**



Qeverisja Demokratike
Democratic Governance

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| Hyrje..... | 2 |
| Metodologjia..... | 3 |
| Standardizimi dhe Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit | 4 |
| Standardizimi në Kosovë - sfidat dhe mundësitë..... | 5 |
| Kosova dhe rajoni në standardizim | 9 |
| Standardizimi dhe politikat e nxitjes së industrive vendore..... | 10 |
| Përfundime..... | 11 |
| Rekomandime..... | 12 |

Lista e figurave dhe tabelave

| | |
|---|----|
| Figura 1. Statistika e tregtisë së jashtme..... | 2 |
| Figura 2. Trekëndëshi i infrastrukturës së cilësisë..... | 4 |
| Figura 3. Shitja e standardeve sipas llojit të subjekti..... | 6 |
| Figura 4. Lista e shitjeve të standardeve në vitin 2017 dhe vitin 2018 deri në qershor..... | 8 |
| Figura 5. Integrimi në mekanizmat evropian..... | 9 |
| Figura 6. Numri i Komiteteve Teknike në Kosovë dhe Rajon..... | 10 |

Hyrje

Lëvizja e lirë e mallërave dhe shërbimeve është njëra nga shtyllat kryesore të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) të nënshkruar në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Si e tillë ajo do të sigurojë se një pjesë e konsiderueshme e produkteve dhe shërbimeve do të qarkullojnë lirshëm në mes të Kosovës dhe tregut të përbashkët evropian. Prodhuesit dhe tregtarët Kosovar kanë tashmë përpara një treg qindra milionësh të konsumatorëve dhe qindra mijëra partnerëve të mundshëm biznesi.

Por edhe pse Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ka hyrë në fuqi me 1 prill të vitit 2016 ajo ende nuk ka prodhuar efektet e dëshirueshme. Përkundrazi, parametrat tregtar tregojnë për rritje të pa balancuar të importit për dallim nga eksporti. Rrjedhimisht deficitit tregtar ishte më i lartë për 7.6% në 2017 sesa në 2016.¹ Kështu, më shumë se dy vite nga hyrja në fuqi e MSA-së, performanca e jashtme tregtare e Kosovës llogaritet tejet e dobët.




Figura 1. Statistika e tregtisë së jashtme¹

Një numër faktorësh kanë ndikuar që deficitit tregtar të rritet vazhdimisht. Kapacitetet e vogla prodhuese dhe investimet konsiderohen si ndër faktorët kryesor. Në anën tjetër, një rol të theksuar kanë edhe mekanizmat që vendosin dhe fuqizojnë kualitetin e produkteve në treg. Në këtë kuptim, standardizimi bashkë me akreditimin dhe metrologjinë përbëjnë shtyllat kryesore të rregullimit institucional dhe ligjor të infrastrukturës së cilësisë së tregut.

Duke adoptuar dhe implementuar standardet, bizneset kosovare përgatiten për të qenë konkurrenente në tregun evropian i cili paraqet potencial të jashtëzakonshëm edhe për uljen e deficitit tregtar por edhe në rritje e cilësisë dhe sigurisë së produkteve dhe shërbimeve në tregun vendor.

Eksporti në vendet e BE-së ndërlidhet ngusht me infrastrukturën e cilësisë në përgjithësi dhe standardizimit në veçanti. Në këtë mënyrë, Kosova do të shfrytëzoj një proces vullnetar siç është

ai i standardizimit, për të maksimizuar benefitet e implementimit të marrëveshjes së stabilizim-asociimit. Infrastruktura e cilësisë, në këtë kuptim, ka një rëndësi të jashtëzakonshme për të siguruar se produktet kosovare janë konkurrense në tregun evropian.

Ky punim mëton të identifikoj progresin dhe sfidat e deritanishme në fushën e standardizimit dhe të japë rekomandime për të ardhmen. Në fokus të tij është që përmes analizës krahasimore dhe të kontekstit ekonomik të Kosovës, të ofrohen rekomandime që do t'i kontribuonin përmbushjes së kriterëve të MSA-së dhe përfitimit sa më të madh nga zbatimi i saj. Duke qenë se standardizimi është një fushë relativisht e re për organizatat e shoqërisë civile në Kosovë, punimi, ndër të tjera ka për qëllim edhe të ofrojë më shumë informata për standardizimin dhe infrastrukturën e cilësisë në Kosovë, dhe t'i hapë dyer involvimit më të madh të shoqërisë civile në këtë fushë.

Metodologjia

Metodologjia për hartimin e këtij punimi ka qenë e përzier, kualitative dhe kuantitative. Në pjesën e hulumtimit kuantitativ, kemi mbledhur të dhëna të shitjes së standardeve në dy vitet e fundit. Në të njëjtën kohë, përmes hulumtimit në tavolinë, ne kemi nxjerrë të dhëna për standardizimin në vendet e rajonit. Hulumtimit kuantitativ i kanë kontribuar edhe të dhënat e nxjerra nga Agjencia Kosovare e Standardizimit, të cilat të dhëna statistike kanë plotësuar mozaikun e të dhënave sekondare.

Në pjesën e hulumtimit kualitativ, ne kemi zhvilluar takime dhe intervistë me përfaqësues të Agjencisë Kosovare të Standardizimit dhe kemi zhvilluar një intervistë edhe me znj. Konstanca Dedja, zyrtare ligjore në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit (DPS) të Republikës së Shqipërisë. Përzgjedhja për intervistë e përfaqësuesve të DPS-së ka qenë për faktin se konteksti kulturor dhe ekonomik është më i ngjashëm sesa me vendet e tjera dhe se Shqipëria ka avancuar që më parë në procesin e implementimit të MSA-së dhe standardeve. Intervistat kanë qenë të tipit gjysmë të strukturuar duke qenë se kemi dashur t'u lëmë hapësirë të intervistuarve të diskutojnë edhe elemente që jo domosdoshmërisht ne i kemi identifikuar si variabla.

Ndonëse me qasje krahasuese, analiza është hartuar duke konsideruar me kujdesë kontekstin e brendshëm politik dhe ekonomik dhe për këtë, gjetjet dhe rekomandimet u janë nënshtruar edhe një testi logjik dhe analize të realizueshmërisë së tyre para se të merreshin konkludime të nevojshme.

Standardizimi dhe Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit




Figura 2. Trekëndëshi i infrastrukturës së cilësisë

Standardizimi është një kornizë e përbashkët e udhëzimeve dhe rregullave për përdorim të përsëritur dhe të uniformuar në një industri të caktuar me qëllim të mbërritjes së vlerës optimale të produktit ose shërbimit. Standardizimi është njëra nga shtyllat e asaj që njihet si infrastruktura e cilësisë e që përfshinë edhe akreditimin dhe metrologjinë. Përdorim të përbashkët dhe të përsëritur për probleme aktuale apo të tjera që mund të krijohen, që ka për qëllim arritjen e një shkalle optimale të rregullit në një kontekst të caktuar. Standardizimi është aktivitet si rezultat i një konsensusi, i realizuar nga dhe për vetë palët e interesit, bazuar në gjithëpërfshirje dhe transparencë¹.

Çka e veçon Standardizimin është natyra vullnetare e tij. Standardet nuk kanë karakter obligativ dhe bizneset mund të zgjedhin që të marrin ato ose jo. Procesi i standardizimit kryhet me konsensus, me komiteteve teknike që janë ekspertë të fushave të cilat komitete janë të përfshirja dhe të përcaktuara me ligj.

Përpos konsensusit, është edhe gjithëpërfshirja dhe transparenca². Pra, në procesin e hartimit të standardeve dhe implementimit të tyre, transparenca dhe gjithëpërfshirja sigurojnë që përshtatja e standardeve evropiane në standarde kombëtare të jetë sa më e lehtë. Në anën tjetër, përmes gjithëpërfshirjes, sigurohet marrja e inputeve nga ekspert të fushave në lidhje me një standard të caktuar dhe në të njëjtën kohë informimi i tyre në lidhje me zhvillimet më të fundit teknologjike dhe të standardeve në ato fusha përkatëse.

Në kuptim të implementimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Standardizimi ka dy rëndësi të theksuara. E para, siguron që të zbatohet një dispozitë mjaftë e rëndësishme e MSA-së që ka të bëjë me nenin 80:

1. Kosova do të marrë masat e nevojshme në mënyrë që gradualisht të arrijë përputhshmërinë me legjislacionin horizontal dhe sektorial të BE-së për sigurinë e produktit dhe të sjellë infrastrukturën e cilësisë, siç janë procedurat Evropiane të standardizimit, metrologjisë, akreditimit dhe vlerësimit të konformitetit.
2. Për këtë qëllim, Palët do të kërkojnë që të:
 - (a) promovimin e përdorimit të rregulloreve teknike të BE-së, standardeve Evropiane dhe procedurave të vlerësimit të konformitetit;
 - (b) të ofrojë ndihmë për nxitjen e zhvillimit të infrastrukturës së cilësisë: standardizimit, metrologjisë, akreditimit dhe vlerësimit të konformitetit;

¹ Republika e Kosovës, (2018), Ligji Nr. 06/L-019 për Standardizimin, Neni 3-Përkulizimet, faqe 1, Prishtinë: GZRKS

² Intervistë e INDEP me znj. Konstanca Dedja – Udhëheqëse e Departamentit Ligjor në Drejtorinë e Standardizimit të Shqipërisë, qershor, 2018.

- (c) promovojë bashkëpunimin e Kosovës me organizatat që kanë të bëjnë me standardet, vlerësimin e konformitetit, metrologjinë, akreditimin dhe funksioneve të ngjashme (p.sh. CEN, CENELEC, ETSI, EA, WELMEC, EUROMET)⁶ nëse rrethanat objektive e mundësojnë këtë;
- (d) sipas nevojës, të arrihen Marrëveshje për Vlerësimin e Konformitetit dhe Pranimin e Produkteve Industriale posa korniza legjislative dhe procedurat e Kosovës janë të përafuara mjaftueshëm me ato të BE-së dhe kur ekspertiza përkatëse është në dispozicion.³

Në anën tjetër, standardet kanë rolin e tyre themeltarë në ngritjen e cilësisë së produkteve vendore dhe bërjen e tyre konkurrencte me tregun evropian. Kjo, përfundimisht ndërlidhet me kaptinën IV të MSA-së mbi krijimin gradual të një zone të lirë ekonomike midis Kosovës dhe BE-së. Vetëm duke rritur cilësinë e produkteve vendore, Kosova do të përmirsoj bilancin tregtar në favor të eksportit dhe ekonomia vendore do të filloj të gëzoj benefitet e zbatimit të kësaj marrëveshje.

Përveç Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Kosova ka marrë obligime në fushën e standardeve edhe me Agjendën Evropiane të Reformave. Plotësimi i bazës ligjore dhe institucionale në fushën e standardeve është pjesë e shtyllës së dytë të Agjendës Evropiane të Reformave mbi rritjen e konkurrueshmërisë dhe klimës së investimeve.⁴ Zbatimi i masave për adoptim të standardeve dhe rritjes së nivelit të standardizimit në treg, në këtë kuptim është i domosdoshëm edhe për përmirësim të klimës së investimeve dhe konkurrueshmërisë në treg.

Standardizimi në Kosovë - sfidat dhe mundësitë

Fusha e standardeve në produkte vendore vazhdon ende të mbetet një temë e pa trajtuar sa duhet në diskursin publik. Në njërën anë, “standardet evropiane” është njëra nga shprehjet më të përdorura, e në anën tjetër statistikatat tregojnë për një numër tejet të vogël të standardeve që blihen dhe aplikohen në produkte kosovare. Pra, ekziston një mungesë e vetëdijes së mjaftueshme mbi rëndësinë e standardeve.

Gjatë vitit 2017, Agjencia Kosovare e Standardizimit ka shitur 159 standarde. Në Shqipëri, për çdo

Agjencia Kosovare e standardizimit është Agjenci qeveritare nën ombrellën e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Roli i saj përcaktohet me Ligjin Nr 06/L-019 për Standardizim. Ajo ka adoptuar mbi 9500 standarde deri më tani. Në procesin e shndërrimit të standardeve nga evropiane në standarde kosovare, një dihmë të konsiderueshme e bënë Republika e Shqipërisë.

Që nga viti 2006 DPS i ka dhënë përafërsisht 4000 standarde AKS-së. Bashkëpunimi vazhdon akoma përpos furnizimit me standarde në të gjitha qelizat e institucionit në fjalë, ku përfshihen përgatitja e akteve ligjore, rregulloreve dhe procedurave të standardizimit, si dhe në përfshirjen e AKS-së në organizimet evropiane dhe ndërkombëtare ku përfaqësues nga AKS-ja iu kanë bashkangjitur delegacionit të DPS.⁵ Në këtë mënyrë, bashkëpunimi me Republikën e Shqipërisë

³ Republika e Kosovës, (2015), Ligji Nr. 05/L-069 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, Neni 80, Standardizimi, metrologjia, akreditimi dhe vlerësimi i konformitetit, faqe 35, Prishtinë: GZRKS.

⁴ Republika e Kosovës, (2016), Dialogu i Nivelit të Lartë Kosovë – BE për Prioritetet Kyçe – Agjenda për Reforma Evropiane (ARC), Prioritetet, faqe 16, Prishtinë, e qasshme në <http://www.mei-ks.net/repository/docs/erafinalsq.pdf> (qasur në qershor, 2018).

⁵ Intervistë e INDEP me znj. Konstanca Dedja – Udhëheqëse e Departamentit Ligjor në Drejtorinë e Standardizimit të Shqipërisë, qershor, 2018.

jo vetëm që i mundëson Kosovës adoptim më të lehtë të standardeve por edhe e bënë që të jetë më prezente në mekanizmat evropian.

Gjithashtu, një tjetër sfidë mbetet edhe numri i vogël i standardeve që blihen. Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e standardeve nga blihen nga subjektet publike. Madje, në kuptim të vlerës monetare, pjesa më e madhe e shitjeve të vitit 2017 dhe gjashtë mujorit të parë të vitit 2018 ka qenë e koncentruar tek subjektet/institucionet publike.



Figura 3. Shitja e standardeve sipas llojit të subjekti

| Viti 2017 | | | | | |
|-------------------------|------------|--------------------------|-----|--|------------------|
| Pala e interesit | Data | Nr. standardeve të blera | € | Nr. identifikues i standardit | Lloji i biznesit |
| IPE - PROING SHPK | 20.01.2017 | 8 | 180 | SK EN 1097-3;933-4;12350-6;12697-10;-23;13286-47;-2;1990; | Privat |
| KMDK SII.A | 20.01.2017 | 21 | 562 | 21 Standarde | Publik |
| KOSOVA-LAB | 16.02.2017 | 5 | 96 | SK EN ISO 4264;10370;12662;12205;3104 | Privat |
| 2-TECH SHPK | 16.02.2017 | 1 | 34 | SK ISO 9001 | Privat |
| KOSOVA-LAB | 22.02.2017 | 9 | 169 | 9 standarde | Privat |
| Krapit Com SHPK | 06.03.2017 | 1 | 15 | SK EN ISO 15927-5 | Privat |
| KEK-Qendra e trajnimeve | 06.03.2017 | 2 | 66 | SK ISO 9001;9606-1 | Publik |
| Krapit Com SHPK | 07.03.2017 | 1 | 45 | SK EN 12831 | Privat |
| AMK | 20.03.2017 | 1 | 0 | SK EN 17065 | Publik |
| NTP EUROLAB | 22.03.2017 | 11 | 234 | SK EN/ISO 15586;13705;14332;15550;16772;11047;11261;11263;11466;12914;11263; | Privat |
| KOSOVA-LAB | 31.03.2017 | 1 | 18 | SK EN 14275 | Privat |
| "KLUGEN" | 14.04.2017 | 1 | 34 | SK ISO 9001 | Privat |
| ERAMED | 20.04.2017 | 1 | 23 | DS ISO/TR 20461 | Privat |
| IT | 05.05.2017 | 12 | 0 | EN ISO 3170;3171;14275;12185;20846;20847;5165;17025;EN 228;15553;12177;13132; | Publik |
| GIZ-KEEP | 15.05.2017 | 6 | 185 | SK EN 16247-1;-2;-3;-4;-5;13790 | Privat |
| N.T.P. DECON | 30.06.2017 | 8 | 274 | SK EN 60439-1;-3;-4;60529;62208;61439-1;-2;-5 | Privat |
| FB/UP | 31.07.2017 | 1 | 16 | SK ISO 5667-12 | Privat |
| FB/UP | 31.07.2017 | 1 | 14 | SK ISO 5667-6 | Privat |

| | | | | | |
|-----------------|------------|----|-----|--|--------|
| KEDS-SH.A. | 16.08.2017 | 1 | 48 | DS ISO/IEC/TR 18001 | Privat |
| Instituti INKOS | 14.09.2017 | 4 | 151 | SK EN 61326-1;-2-2;61010-1;61010-031; | Privat |
| Instituti INKOS | 29.09.2017 | 3 | 95 | SK EN 12341;15859;2719 | Publik |
| Instituti INKOS | 04.10.2017 | 6 | 204 | SK EN 30326-1;11200;14791;14782;14789;15508; | Publik |
| AMK | 10.10.2017 | 1 | 0 | SK EN 9001 | Publik |
| Instituti INKOS | 10.10.2017 | 7 | 166 | DS CEN ISO/TS 17892-4;-5;-7;-8;-9;10;-12; | Publik |
| FINA/UP | 18.10.2017 | 1 | 8,5 | SK EN 12697-36 | Privat |
| Phoenix Pharma | 07.11.2017 | 1 | 34 | SK EN 9001 | Privat |
| UBT | 19.12.2017 | 44 | 473 | 44 SK | Privat |

| Viti 2018 | | | | | |
|--------------------------|------------|---|----|-------------------------|--------|
| MMPII | 14.02.2018 | 4 | 0 | SK EN 1998-1;2;3;4;5;6; | Publik |
| AMK | 15.02.2018 | 2 | 0 | SK EN 837-1;-3; | Publik |
| AMK | 16.02.2018 | 1 | 0 | SK EN 12645; | Publik |
| GMC Kosova SH.P.K. | 22.02.2018 | 1 | 29 | SK EN ISO/IEC 17020; | Privat |
| NPN "BALLKAN PROJEKT" | 08.03.2018 | 3 | 74 | SK EN 13286-2;-4;-4/; | Privat |
| AMK | 28.03.2018 | 1 | 0 | SK EN ISO/IEC 17025; | Publik |
| EuroProject SHPK | 16.04.2018 | 1 | 17 | SK EN ISO 3834-2 | Privat |
| KOSOVA-LAB | 28.05.2018 | 1 | 32 | SK EN ISO/IEC 17025; | Privat |

Figura 4. Lista e shitjeve të standardeve në vitin 2017 dhe vitin 2018 deri në qershor

Kosova dhe rajoni në standardizim

Specifikat e Kosovës bëjnë që pothuaj ëfarëdo krahasimi me vendet e rajonit të jetë i padrejtë. Në njërin anë, Agjencia Kosovare e Standardizimit nuk është e barabartë me institucionet homologe në rajon për shkak të mungesës së integritimit në mekanizmat evropian të standardizimit, e në anën tjetër edhe ekonomia e Kosovës ende s'është zhvilluar në përmasa që të ketë shitje dhe implementim të madh të standardeve. Sidoqoftë, elementet krahasuese janë të rëndësishme në mënyrë që të identifikohen sfidat dhe mundësitë për të ardhmen.

Për dallim nga vendet e rajonit Kosova nuk është anëtarësuar në mekanizma evropian.

| | Kosova | Maqedonia | Shqipëria | Mali i Zi | Serbia |
|---------------------------------|--------|---|--|--|--|
| Antarsimi në mekanizma evropian | / | 1. Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit (Me të drejta të plota nga 1995), 2. Komiteti Ndërkombëtar Elektro-Teknik (Me të drejta të plota nga 2012), 3. Komiteti Evropian i Standardizimit (Me të drejta të plota nga 2012), 4. Komiteti Evropian për Standardizim Elektro-Teknik (Anëtare e asociuar nga 2005), 5. Instituti Evropian i Telekomunikimeve (nga 2006). | Anetare e asociuar në CEN dhe CENELEC, me të drejta të plota në ETSI | ISO nga 2009; IEC nga 2009 dhe anëtare e asociuar në CEN dhe CENELEC | 1. ETSI nga 2011; 2. ISO nga 1950 ; 3. ECI nga 1953; IECEE nga 1965; CEN dhe CENELEC nga 2017 |

Figura 5. Integrimi në mekanizmat evropian

Mungesa e të qenit anëtar në mekanizma evropian i vështirëson punën jashtëzakonisht shumë. Në radhë të parë, prezenca në mekanizmat evropian rritë kapacitetet e Agjencisë dhe mundëson përfaqsim të interesave të shtetit në mekanizma ku vendoset mbi standardet. Në momentin që një shtet është me të drejta të plota, vendi që anëtarësohet ka të drejtë të hartojë dhe miratojë standarde të caktuara të cilat kanë rëndësinë e vet për fusha të caktuara, pra pjesëmarrja dhe e

drejta e votës për interesa kombëtare ka rëndësi të madhe dhe strategjike për vendin.⁶ Përparësitë e tjera të cilat shtetet që gëzojnë anëtarësim në mekanizma evropian përfshijnë edhe mundësinë e ngritjes së kapaciteteve për institucionet vendore, shkëmbimit të përvojave etj.

Një numër i madh i shteteve kanë shumë më tepër komitete teknike sesa Kosova. Vetëm Serbia ka 191 komitete teknike.⁷ Kroacia ka 185 komitete teknike ndërkohë që Shqipëria ka 61 komitete. Edhe shtetet e tjera kanë një numër më të madh të komiteteve përveç Malit të Zi.




Figura 6. Numri i Komiteteve Teknike në Kosovë dhe Rajon

Numri i komiteteve teknike, megjithatë, varet drejtpërdrejtë nga kërkesat për standarde dhe mungesa e kërkesave bënë që për një pjesë të standardeve Agjencia të mos ketë interesim që të formoj Komitete të reja dhe të adoptoj këto standarde. Si edhe në Kosovë, edhe në Shqipëri dhe në vendet e tjera të rajonit, pjesëmarrja vullnetare në këta trupa e bënë të vështirë mbledhjen e anëtarëve dhe zhvillimin e suksesshëm të grupeve të punës.

Standardizimi dhe politikat e nxitjes së industrive vendore

Për vendet e rajonit, standardizimi nuk është thjeshtë një produkt që shitet varësisht nga kërkesa e bizneseve apo subjekteve të tjerë të interesuar. Qeveritë e këtyre vendeve kanë inicuar skema për të mbështetur grupe të caktuara shoqërore që të mund të pajisen me standarde. Në këtë mënyrë, ato, duke përdorur përparësitë krahasuese të vendit të tyre, përdorin standardet për zhvillim të atyre sektorëve.

Kjo politikë, jo vetëm që u mundëson këtyre shteteve të pajisin me standarde grupe të cilat ato mëtojnë t'i pajisin me standarde, por edhe tregon një ndërlidhje të politikave ndërsektoriale për të mbërritur një rezultat të caktuar. Për shembull, në Republikën e Shqipërisë, studentët e paguajnë vetëm 15% të vlerës së një standardi.

Përveç mbështetjes që i jepet bizneseve, që kërkohet edhe nga rekomandimet që dalin nga dokumentet e Bashkimit Evropian, gjithashtu edhe NMV-ve dhe studentëve që janë target group, këto lehtësira janë strategjike jo vetëm në afat të shkurtër, por edhe për t'i angazhuar dhe përgatitur ata si klient të ardhshëm apo përdorues të standardeve. Kjo me qëllim që të në të ardhmen të ketë gjeneratë operatorësh ekonomik që dinë çfarë është standardi, rëndësinë dhe benefitet e tij, e që do të sillte një numër akoma më të madh të përdorimit të

⁶ Intervistë e INDEP me znj. Konstanca Dedja – Udhëheqëse e Departamentit Ligjor në Drejtorinë e Standardizimit të Shqipërisë, qershor, 2018.

⁷ Republika e Serbisë, (2018), Për Institutin për Standardizim të Serbisë e qasshme në <http://www.iss.rs/en> (qasur në qershor, 2018).

standardeve dhe njëkohësisht do të rriste sigurinë dhe cilësinë e produkteve apo shërbimeve të ofruara.⁸

Pra, krahas përkrahjes me mekanizma të tjerë shtetëror, edhe përmes standardizimit, Republika e Shqipërisë tenton të mbështesë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Gjithashtu, inkurajimi që i bëhet të rinjëve që të pajisen me standarde dhe të edukohen mbi rëndësinë e tyre është shumë i rëndësishëm. Kjo pasi vet standardet nuk kanë vetëm dimensionin e ngritjes së cilësisë së shërbimeve, por edhe të edukimit, nxitjes së ndërmarrësisë, inovacionit dhe debatit mbi rregullat teknike dhe përmbajtjen e standardeve.

Përfundime

Standardizimi në njërën anë siguron rritje të cilësisë së produkteve, në anën tjetër është mjet i shkëlqyer për bizneset që të maksimizojnë rezultatet e prodhimit/menaxhimit operacional, duke siguruar efikasitet, krijim dhe menaxhim të njohurive mbi procese komplekse të prodhimit dhe menaxhimit dhe nxitje të konkurrueshmërisë në treg të brendshëm dhe të jashtëm. Në këtë kuptim, edhe pse për nga natyra janë vullnetare, standardet janë një domosdoshmëri e një tregu gjithnjë e më të gjerë e të ndërvarur ku kërkesat për produkte janë tejet specifike dhe konkurrenca në treg është e lartë.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Kosova ka mundësinë të përfitoj nga një treg i gjerë i përbashkët i BE-së. Megjithatë, siç po tregojnë statistikat e dy viteve të para, MSA-ja nuk ka ndikuar në uljen e deficitit tregtar. Përkundrazi, trendi i rritjes së tij ka vazhduar! Kjo tregon se nevojitet shumë më tepër edhe në rritjen e volumit por edhe të kualitetit të produkteve vendore. Përfundimisht, standardizimi dhe infrastruktura e cilësisë janë të domosdoshme në mbërritjen e objektivave të MSA-së.

Kosova është në fazë të hershme të funksionalizimit të mekanizmave ligjor dhe instituional në fushën e standardizimit. Ndonëse Agjencia e Standardizimit është funksionale dhe kryen detyrat e parapara me ligj, numri i vogël i standardeve të shitura tregon për mungesë suksesi në këtë fushë. Kosova shet rreth 6 herë më pak standarde sesa Shqipëria dhe shumëfish më pak se sa vendet e rajonit. Edhe pse një pjesë e problemit është tek ekonomia jo e fortë për të nxitur investime në rritje të cilësisë, një pjesë e konsiderueshme e problemit është edhe tek mungesa e vetëdijësisë të bizneseve mbi benefitet e pajisjes dhe përshtatjes me standardin.

Agjencia Kosovare e Standardizimit ka mungesë kapacitësh dhe për dallim prej vendeve të tjera është e izoluar nga anëtarësimi në mekanizma evropian të standardizimit. Kësisoj, Agjencia është e privuar nga pjesëmarrja në harmonizimet e standardeve në nivel evropian dhe nga shkëmbimi i përvojave dhe ngritja e kapaciteteve. Gjithashtu, Kosova ka numër të vogël të komiteteve teknike dhe pjesëmarrja e ekspertëve nëpër komitete arrihet me shumë vështirësi.

Mungojnë mekanizma incentivues për marrje të standardeve dhe ndarje të çmimeve sipas kategorive të cilat Ministria dhe Agjencia duan t'i nisin të marrin standarde. Agjencia nuk ka ndonjë mekanizëm të marketingut për standarde tek biznese dhe mungon një strategji e mirëfilltë e promovimit të pajisjes me standard dhe implementimit të standardeve. Shtetet e rajonit kanë

⁸ Intervistë e INDEP me znj. Konstanca Dedja – Udhëheqëse e Departamentit Ligjor në Drejtorinë e Standardizimit të Shqipërisë, qershor, 2018.

përcaktuar zbritje të çmimeve për kategori të caktuara shoqërore me qëllim të nxitjes së blerjes së standardeve.

Rekomandime

Një numër masash janë të domosdoshme në mënyrë që gjendja të përmirësohet në fushën e standardizimit. Kosova duhet të fuqizoj bazën institucionale në njërin anë dhe të punoj me subjektet ekonomike që të promovoj standardet në anën tjetër. Përveç kësaj, integrimi i AKS-së në mekanizma evropian do t'i hapte rrugë zhvillimit të mëtejshëm të sektorit dhe Agjencia do të gëzonte benefite që do të rrisnin performancën e saj dhe efikasitetin e sistemit në përgjithësi.

Një strategji kombëtare e promovimit të standardeve është e domosdoshme. Kjo sepse, një pjesë e konsiderueshme e subjekteve ende nuk janë të vetëdijësuar sa duhet rreth standardeve dhe rëndësisë së pajisjes me to. Promovimi do të nënkuptonte të punohet drejtëpërdrejtë me odat e biznesit, klubet e prodhuesve, ARBK-në dhe mekanizmat e tjerë që të ketë informim të vazhdueshëm mbi standardet. Kur një biznes regjistrohet, ai duhet të pajiset me një listë të standardeve që potencialisht mund t'i blejë në vartësi nga natyra e biznesit. Më tutje, programe të edukimit për të rinjtë mund të kenë efekt shumë të madh në promovimin e standardeve.

Agjencia e Standardizimit duhet të ketë së paku kapacitetet e Drejtorisë së Standardizimit të Shqipërisë. Në këtë mënyrë, ajo do të mund të ofronte disa shërbime falas si një bibliotekë me të gjitha materialet falas për lexim, këshillim për standarde etj. Një pjesë e shërbimeve duhen ofruar falas dhe Agjencia duhet t'i propozoj Ministrisë një listë lehtësirash për grupe të caktuara të subjekteve ekonomike që është e rëndësishme të pajisen me standarde.

Agjencia duhet të zgjeroj numrin e komiteteve teknike. Vetëm me gjithëpërfshirje dhe transparencë është mundshme që interesat e Kosovës të mbrohen gjatë adoptimit të standardeve ndërkombëtare dhe evropiane. Në të njëjtën kohë, duhen gjetur mënyra të incentivimit të pjesëmarrjes nëpër punime të komiteteve teknike dhe duhet siguar se komitetet teknike vazhdimisht pasurohen me ekspert të rinj të fushave. Përfundimisht, pa një prioritizim më të shtuar të standardizimit bashkë me gjithë mekanizmat institucional që e përbëjnë, Kosova nuk do të mund të gëzojë benefitet e plota të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.